



26 KORRIK 2023

Në datën 26 korrik 2023, në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor u zhvillua mbledhja e parë e grupit të punës për hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykata.

Në këtë mbledhje të parë ishin të pranishëm zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi, anëtarët znj. Irena Plaku dhe z. Ridvan Hado, zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Apelit z. Ardian Dvorani, zëvendëskryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë z. Flamur Kapllani dhe zëvendëskryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë z. Gentian Hamiti.

Gjithashtu morën pjesë edhe përfaqësues nga Këshilli i Evropës, ekspertet e projektit “Ulja e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Përmirësimi i Efikasitetit në Gjykatën e Lartë të Shqipërisë”, i zbatuar nga East-West Management Institute (EWMI) si dhe përfaqësues nga Byroja për Çështjet Ndërkombëtare të Lëndëve Narkotikëve dhe të Zbatimit të Ligjit, Departamenti Amerikan i Shtetit (INL).

Objekti i kësaj mbledhjeje të parë ishte prezantimi i situatës, me qëllim hartimin e strategjisë për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykatat e shkallës së parë administrative dhe në Gjykatën Administrative të Apelit.

Pjesëmarrësit në mbledhje diskutuan mbi hartimin e një plan veprimi me masa konkrete me qëllim vlerësimin e situatës dhe hartimin e propozimit për standardet minimale të afatit për gjykimin e llojeve të ndryshme të çështjeve gjyqësore, nevojën për caktimin e standardeve sasiore dhe hartimin e propozimit mbi normën e likuidimit të çështjeve për gjyqtar, numrin e nevojshëm të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit si dhe numrin e nevojshëm për ndihmës ligjor në gjykata.



15 SHTATOR 2023

Në kuadër të zbatimit të Planit të Komunikimit për Gjykatat, me mbështetjen e prezencës së Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Këshilli i Lartë Gjyqësor organizoi një tryezë të përbashkët, në nivel rajonal.

Në këtë takim ishin të pranishëm znj. Marçela Shehu anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor, e caktuar për Marrëdhëniet me Median dhe Publikun, z. Cailean Maclean shef i Departamentit Ligjor dhe të Drejtave të Njeriut pranë OSBE, gjyqtarë të caktuar për mediat, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të mediave si dhe përfaqësues nga bota akademike.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth rolit të Gjyqtarëve për Median në fuqizimin e marrëdhënieve midis gjykatave, shoqërisë civile dhe mediave.

Ndërtimi, mbajtja dhe zhvillimi i komunikimit me median është një aspekt shumë i rëndësishëm i punës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një udhëheqje dhe qeverisje të sistemit gjyqësor me performancë të lartë, që meriton besimin e publikut dhe medias.



Në datën 18 shtator 2023, Kryetarja e KLGj-së, znj. Naureda Llagami e shoqëruar nga zëvendëskryetari, z. Ilir Rusi si dhe anëtarja, znj. Brikena Ukperaj pritën në një vizitë zyrtare pune, një delegacion nga Mbretëria e Arabisë Saudite.

Delegacioni, kryesohej nga Sheikh.Dr. Waleed Mohammed Al-Samaani, Ministri i Drejtësisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Vizita e Ministrit Waleed Al-Samaani, i cili mban njëkohësisht dhe pozicionin e Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendeve Arabe, është vizita e parë e një Ministri të Mbretërisë së Arabisë Saudite në Shqipëri.

Pjesëmarrësit në takim diskutuan mbi marrëdhëniet mes dy vendeve duke u fokusuar më së shumti tek roli i Këshillave në garantimin e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve gjyqësore. Digjitalizimi i shërbimeve gjyqësore dhe përdorimi i inteligjencës artificiale, paralelisht me rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, janë disa nga sfidat por njëkohësisht edhe mundësitë për të ardhmen e sistemeve gjyqësore.

Në mbyllje të takimit, palët u angazhuan për rritjen e bashkëpunimit në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave midis institucioneve respektive në të ardhmen, sidomos në kontekstin e transformimeve digjitale të shërbimeve gjyqësore, për të mundësuar një drejtësi efikase, transparente dhe të shpejt për publikun.



19 SHTATOR 2023

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, e shoqëruar nga zëvendëskryetari, z. Ilir Rusi si dhe kryetarët e komisioneve të përhershme znj. Marçela Shehu dhe z. Klodian Kurushi, zhvilluan një takim prezantues me ekspertin ndërkombëtar të projektit “EU4Justice”, gjyqtarin spanjoll, z. Arturo Valdes.

Ky takim u realizua në kuadër të vijimësisë së bashkëpunimit midis Këshillit dhe projektit, me qëllim forcimin e pavarësinë, transparencës, efikasitetit, llogaridhënies, dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira europiane.

Në mbyllje të takimit, z. Arturo Valdes prezantoi planin e veprimit për 6 mujorin e ardhshëm, i cili u dakordësua nga palët me qëllim arritjen e objektivave në të ardhmen.



20 SHTATOR 2023

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, së bashku me anëtarët e KLGJ-së, pritën në një vizitë zyrtare pune, përfaqësues nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Republikës së Bullgarisë.

Ardhja e këtij delegacioni në Shqipëri, kishte si qëllim shkëmbimin e eksperiencave midis dy institucioneve homologe në kuadër të forcimit të bashkëpunimit në fushën e sistemit gjyqësor dhe përballjen e sfidave të përbashkëta.

Gjatë takimit u diskutua mbi reformat në drejtësi që të dyja vendet kanë ndërmarrë duke u ndalur veçanërisht tek roli, organizimi dhe funksionimi i këshillave, si institucione që garantojnë pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor. Vëmendje të shtuar gjatë diskutimeve morën procedurat e promovimit të gjyqtarëve si dhe harta e re gjyqësore, zbatimi i së cilës ka qenë një ndër sfidat dhe projektet më madhore të Këshillit, i cili tashmë është një realitet i prekshëm për publikun.

Gjatë datave 20-22 shtator 2023, delegacioni i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Republikës së Bullgarisë do të zhvillojë takime pune edhe me përfaqësues të tjerë nga institucionet më të larta të sistemit të drejtësisë në Shqipëri.



26 SHTATOR 2023

Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, priti në një takim zyrtar pune delegacionin e reporterëve nga Këshilli i Evropës (KiE), në kuadër të vizitës së tyre faktë-mbledhëse periodike në Shqipëri.

Takimi u fokusua tek reforma në drejtësi, arritjet dhe sfidat si dhe impakti i saj në besimin e publikut. Procesi i rivlerësimit kalimtar të magistratëve, stoku i çështjeve të prapambetura, emërimet dhe promovimet në sistem, si dhe harta e re gjyqësore ishin disa nga çështjet për të cilat reporterët e KiE-së shfaqën interes gjatë diskutimit.

Takimi u përmbyll me konsideratat më të larta mes pjesëmarrësve për bashkëpunimin e frytshëm dhe mbështetjen e ofruar nga KiE për institucionet e reja të drejtësisë, përfshirë edhe KLGJ-në, përmes projekteve dhe asistencës teknike të dhënë ndër vite.



Në datën 27 shtator 2023, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, priti në një takim pune ekspertët e Komisionit Evropian, z. Dario Quintavalle dhe z. Thomas Traar, të cilët shoqëroheshin nga përfaqësuesja e Delegacionit të BE-së, znj. Tidita Fshazi.

Ekspertët e Komisionit Evropian ndodhen në Shqipëri në kuadër të vizitës faktë-mbledhëse, e fundit e zhvilluar që në vitin 2016, me fokus efikasitetin në drejtësi por tashmë në një kontekst tërësisht të ri.

Takimi pati në qendër të diskutimeve situatën në sistemin gjyqësor post-reformës në drejtësi, zbatimin e hartës së re gjyqësore, si dhe stokun e çështjeve që janë në pritje për tu gjykuar.

Vlerësimi i performacës në sistemin gjyqësor, emërimet e reja në sistem, vlerësimi etiko-profesional i gjyqtarëve si dhe mekanizmat ligjore dhe administrativ të ndërmarrë nga Këshilli për të adresuar problematikat e hasura ndër vite, ishin gjithashtu disa nga çështjet objekt diskutimi gjatë takimit.



Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, zhvilloi një takim me gjyqtarët e rinj të diplomuar nga Shkolla e Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi mbi ecurinë e procesit të emërimit të gjyqtarëve të sapo diplomuar dhe problematikat e hasura nga Këshilli në këtë proces.

Në kushtet që ndodhet sistemi gjyqësor dhe nevojës për shtimin e burimeve njerëzore nëpër gjykata, Këshilli e ka patur dhe vazhdon ta ketë prioritet të veprimtarisë së tij furnizimin e sistemit me profesionistë të rinj. Ndaj në këtë kontekst, Kryetarja i konfirmoi pjesëmarrësve në takim se tashmë, procesi i emërimit të gjyqtarëve të sapo diplomuar është në rrugën e duhur dhe pritet të realizohet në ditët në vijim.

- Në kuadër të procesit të vlerësimit etiko profesional të gjyqtarëve si dhe atij të ngritjes në detyrë, Këshilli gjatë **3 muorit të tretë 2023** vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional, për **5 gjyqtarë** për periudhën 2017-2019 dhe për **2 gjyqtarë** për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Gjithashtu, Këshilli miratoi raportet për vlerësimin etik dhe profesional të **3 gjyqtarë** për vitin 2022.
- Në vijim të procesit për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, Këshilli vendosi miratimin e raporteve të vlerësimit etik dhe profesional të **2 gjyqtarëve** të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor, respektivisht për **1 gjyqtare** për periudhën e vlerësimit 01.01.2019 – 07.02.2020 dhe për **1 gjyqtar** për periudhën 01.01.2019 – 01.06.2020.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi miratimin e rregullave për zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.
- Këshilli miratoi vendimet për propozimin e **znj. Vojsava Kola** dhe **z. Valbon Cekrezi** për emërim në Gjykatën e Lartë.
- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurave të lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës**, për kandidatët:
 - Znj. Yrfet Shkreli, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 23, datë 18.01.2023;
 - Z. Ardit Kuka për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 22, datë 18.01.2023;
 - Znj. Kostandina Kuro, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023;
 - Z. Xhevdet Lika, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023;
 - Znj. Entela Gjoni, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023;
 - Znj. Suela Dashi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 24, datë 18.01.2023.
- Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurave të lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë**, për kandidatët:
 - Znj. Amarilda Sulaj, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimin nr. 14 dhe nr. 15, datë 18.01.2023;
 - Z. Ervin Sulaj, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023;
 - Z. Arben Dosti, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 14, datë 18.01.2023.
- Në vijim, Këshilli miratoi vendimet për kualifikimin dhe vijimin e procedurave të lëvizjes paralele në **Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan**, për kandidatët:
 - Z. Artur Prenga, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 dhe nr. 251, datë 24.05.2023;
 - Znj. Thomaidha Roça, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 datë 24.05.2023, dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023;
 - Z. Gjergji Baçi, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 248 dhe nr. 251, datë 24.05.2023;
 - Z. Ardit Kuka për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 249, datë 24.05.2023;
 - Znj. Kostandina Kuro për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 251, datë 24.05.2023;
 - Znj. Suela Lika për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 253, datë 24.05.2023.

- Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimet për kualifikimin e kandidatëve dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në **Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm** për:
 - Znj. Oltjona Goxha, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 504, datë 21.11.2022;
 - Znj. Matilda Fetau, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022;
 - Z. Gerd Hoxha, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 502, datë 21.11.2022;
 - Znj. Elvana Çiçolli, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 504, datë 21.11.2022;
 - Znj. Engjëllushe Tahiri, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 502 dhe nr. 503 datë 21.11.2022.
- Në respektim të dispozitave ligjore, Këshilli vendosi për transferimin e gjyqtarëve **z. Edvan Veçani, znj. Esmeralda Xhili, z. Gentian Marku dhe z. Artan Hajredinaj** për shkak të lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe të **znj. Kostandina Kuro** në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.
- Këshilli ka vendosur ngritjen në detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të **znj. Elsa Ulliri dhe znj. Atalanta Zeqiraj**.
- Në fokus të veprimtarisë së tij gjatë këtyre muajve, Këshilli ka pasur edhe procesin e plotësimit të vendeve vakante në gjykata edhe përmes skemës së delegimit, në të cilën u përfshinë **2 gjyqtare** dhe zgjatjen e afatit të caktimit në këtë skemë për **1 gjyqtarë**.
- Gjithashtu ka vendosur të deklarojë mbarimin e statusit për **1 gjyqtar**.
- Këshilli miratoi vendimet përkatëse për kualifikimin për emërim në shërbimin civil gjyqësor të **znj. Jona Biba dhe znj. Kristina Gaçe**, për pozicionin e ndihmësit ligjor në njësitë e shërbimit ligjor pranë gjykatave të apelit.
- Këshilli i Lartë Gjyqësor filloi procedurën e verifikimit të kandidatëve fitues në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjorë, për vitin akademik 2023-2024.
- Në përfundim të procedurave të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, të diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2022-2023, Këshilli vendosi kualifikimin **për emërim të 40 kandidatëve**.

DISIPLINA DHE TRANSPARENCA




Me qëllim ruajtjen e integritetit gjyqësor, gjatë kësaj periudhe, Këshilli ka vijuar me shqyrtimin në seancë dëgjimore publike të kërkesave së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për fillimin e procedimeve disiplinore nr. 3/2022; nr. 1/2023 dhe nr. 2/2023 në ngarkim të magistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}, ka ka vendosur pezullimin procedimeve disiplinore për një afat kohor 1 vjeçar.

Me qëllim plotësimin e trupave gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor trajtoi **26 kërkesa për caktimin e 34 gjyqtarëve të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta** në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

KLJGJ, në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit, gjatë kësaj periudhe, ka trajtuar **10 kërkesa për informacion**, të ardhura si përmes postës elektronike ashtu edhe në rrugë zyrtare, të cilat morën përgjigje brenda një afati të arsyeshëm.

Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun me Jashtë dhe Botimet ka trajtuar **154 shkresa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë, organizata dhe institucione publike dhe jopublike.

Veprimtaria e KLGJ-së (korrik-shtator 2023):



- 13 mbledhje plenare
- 162 akte të miratura në ndihmë të të gjithë sistemit gjyqësor, më konkretisht:
 - 17 akte kolektive, Korrik 2023
 - 0 akte kolektive, Gusht 2023
 - 7 akte kolektive, Shtator 2023
 - 98 akte individuale, Korrik 2023
 - 0 akte individuale, Gusht 2023
 - 23 akte individuale, Shtator 2023

Pjesa tjetër përfshihen 3 akte normative nënligjore dhe 14 rregulla të brendshme.



KLGG FACEBOOK

Ndjekës në total

2469

-na ndiqni-

Adresa: Godina "Poli i Drëjtësisë", Rruga "Ana Komnena", Tiranë

www.klgj.al

email: kontakt@klgj.al